



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-033
Prishtinë, më 5, 6, 8 dhe 14 qershor 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 5, 6, 8 DHE 14 QERSHOR 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala dhe Mufera Srbica-Shinik.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018.

Seanca i zhvilloi punimet me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Driton Selmanaj, Nait Hasani, Arbër Rexhaj, Dardan Molliqaj, Ahmet Isufi, Zafir Berisha, Veton Berisha, Bahrin Shabani, Avdullah Hoti, Blerta Deliu-Kodra, Glauk Konjufca, Daut Haradinaj, Imet Rrahmani dhe Ganimete Musliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Naser Rugova i parashtrori pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me trasenë e ndërtimit të autostradës Istog - Prizren.
Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Haxhi Avdyli i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga kjo ministri për punësimin e profesionistëve shëndetësorë, të cilët janë të papunë.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga kjo ministri për zvogëlimin e peshës së çantës së nxënësve.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me shkuarjen e maturanëve në ekskursione në Shqipëri.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Valon Ramadani i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me funksionalizimin e spitalit në komunën e Shtërpcës.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Adem Mikullovc i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Qeveria për kthimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të marrë nga Serbia.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Drita Millaku i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me një peticion të studentëve të Prizrenit në muajin shkurt 2017, drejtuar ministrit të atëhershëm të Arsimit, z. Arsim Bajrami.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Shemsi Sylja i parashtrroi pyetje ministrit të Forcës së Sigurisë, Rrustem Berisha, në lidhje me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, sipas Strategjisë së rishikuar të Sektorit të Sigurisë 2014 – 2024.

Ministri Rrustem Berisha nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Driton Çausi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Qeveria për përmbushjen e rekomandimeve të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës për Bordin dhe Menaxhmentin e Agjencisë së Veterinarisë dhe Ushqimit për sigurinë e ushqimit dhe skandalit me mishin e importuar.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve të kësaj ministrie për furnizim me barna nga lista esenciale.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Armend Zemaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me masat e ndërmarra nga institucionet e sigurisë për parandalimin dhe luftimin e shitjes dhe përdorimit të drogave të rinjtë.

Ministri Bejtush Gashi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Armend Zemaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me masat e ndërmarra nga kjo ministri për rregullimin e pranimit të stazhit për zyrtarët policorë të viteve të '90-ta.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Qeveria për marrjen në menaxhim të hapësirës ajrore nga autoritetet kosovare.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra i parashtrroi pyetje zëvendëskryeministrit, njëherësh ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, në lidhjet me veprimet e ndërmarra nga Ministria e Punëve të Jashtme për ndaljen e fushatës së Serbisë kundër njohjeve të pavarësisë së Kosovës.

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra i parashtrroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, në lidhjet me veprimet e ndërmarra nga kjo ministri për t'i ndihmuar familjet të cilat janë dëmtuar nga breshri.

Ministri Nenad Rikalo nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Naser Rugova i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me menaxhimin e mbeturinave të produkteve medicinale.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Arbërie Nagavci i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për fillimin e procesit të akreditimit të shkollave publike, si detyrë e paraparë në lidhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Ministri Shyqiri Bytyqi, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetes.

Deputeti Korab Sejdiu i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim zëvendëskryeministrit, njëherësh ministrit të Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për adresimin e kërkesave të diasporës.

Zëvendëskryeministri, respektivisht ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

Deputeti Korab Sejdiu i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri pas praktikave të Administratës Tatimore të Kosovës për moszbatimin e Ligjit për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Ministri Bedri Hamza, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

* * *

Në vazhdim, ministri Skender Reçica, në emër të kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, e tërhoqi Projekt-platformën shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve.

* * *

Nënkryetari i Kuvendit, Slavko Simiq, propozoi që pika 16, Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë të shtyhet për një seancë tjetër. Diskutimi i plotë i të cilit është i dhënë në transkript.

Deputeti Armend Zemaj propozoi që dy interpelancat nga pikat 4 dhe 5 të rendit të ditës të shtyhen për një ditë tjetër.

Lidhur me propozimet e lartcekura të nënkryetarit të Kuvendit, z. Simiq dhe deputetit Armend Zemaj, diskutuan deputetët: Saranda Bogujevci, Memli Krasniqi, Duda Balje, Sasha Milosavljeviq, Albulena Haxhiu, nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, Muharrem Nitaj dhe Bilall Sherifi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kuvendi i miratoi propozimet e lartshënuara: pika 16, Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë shtyhet për një seancë tjetër dhe dy interpelancat nga pikat 4 dhe 5 shtyhen për një ditë tjetër.

* * *

Në vazhdim, kryesuesi procedoi me pikat e tjera të rendit të ditës, si në vijim:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave të mbajtura më 27 prill dhe 3 e 18 maj 2018.

6. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projekt-kod.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projekt-kodi.

Lidhur me Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”; Vjosa Osmani-Sadriu, Luljeta Veselaj-Gutaj, Fatmire Kollçaku, Teuta Haxhiu, Milaim Zeka, Sami Kurteshi, Veton Berisha, Armend Zemaj, Blerta Deliu-Kodra, Time Kadrijaj, Korab Sejdiu, Bekim Haxhiu, Adem Mikullovc, Xhevahire Izmaqu dhe Muharrem Nitaj, si dhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij Projekt-kodi Penal shtyhet.

Votimi në parim i Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës është bërë më 6 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 58,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 4.

Kuvendi me shumicë vozash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projekt-kodi Penal nr. 06/L-074 i Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projekt-kodin Penal dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Driton Selmanaj, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Korab Sejdiu, Dardan Sejdiu, Ganimete Musliu, Avdullah Hoti si dhe ministri i Financave, Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare është bërë më 6 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 56,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 5.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-072 për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 19:20

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Në vazhdimin e seancës plenare Kuvendi i miratoi në parim Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Projektligjin për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Rezultatet e votimeve janë pasqyruar së bashku me shqyrtimet e pikave përkatëse.

Pastaj, seanca plenare i vazhdoi punimet me pikat e rendit të ditës si në vijim:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor diskutuan deputetët: Dardan Sejdiu, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik dhe në emër të GP të PSD-së; Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të NISMA-s; Danush Ademi, në emër të GP “6+”, Salih Zyba si dhe ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 54,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor.

2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme diskutuan deputetët: Dardan Sejdiu, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe në emër të GP të PSD-së; Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së; Xhelal Sveçla, në emër të GP të LVV-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të NISMA-s dhe Islam Pacolli, si dhe ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 57,
Kundër ----- 6,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe në emër të GP të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Salih Zyba, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu në emër të GP të PSD-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 50,
Kundër----- 15,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shofer

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shofer dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shofer. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shofer diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe në emër të GP të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Haxhi Avdyli, Islam Pacolli dhe Korab Sejdiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 53,
Kundër----- 13,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-066 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shofer.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në

emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik dhe në emër të GP të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s dhe Adem Mikullovc, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 50,
Kundër----- 13,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik dhe në emër të GP të PDK-së dhe Valon Ramadani, në emër të GP të LVV-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 52,
Kundër----- 14,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-067 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike

Kryesuesi theksoi se në mungesë të përfaqësuesit të Qeverisë, shtyhet shqyrtimi i këtij projektligji.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Projektligjin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Deputetja Ganimete Musliu në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Në fund, ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz diskutuan deputetët: Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Bekim Haxhiu, në emër të GP të PDK-së; Shemsi Syla, në emër të GP të LVV-së; Driton Çausi, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Islam Pacolli dhe Sami Kurteshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 75,
Kundër----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-059 për Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryesuesi e ftoi kryetaren e Komisionit Funkcional ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Kryetarja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Besa Baftiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin si dhe kërkoi nga deputetët që ta miratojnë raportin me rekomandime.

Për këtë raport diskutuan: Haxhi Avdyli, në emër të GP të LDK-së; Flora Brovina, në emër të GP të PDK-së; Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Besa Baftiu, në emër të GP të PSD-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s, Naser Rugova, Mirjeta Kalludra, Xhevahire Izmaqu dhe Adem Mikullovc, si dhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 4.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

18. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017 diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s, Hajdar Beqa, Bekim Haxhiu dhe Arbër Rexhaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 59,
Kundër----- 11,
Abstenime----- 6.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017.

19. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017 diskutuan deputetët: Dardan Sejdiu, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PSD-së; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në

emër të GP të LVV-së; Milaim Zeka, në emër të GP të NISMA-s, Korab Sejdiu dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 54,
Kundër----- 11,
Abstenime----- 3.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017.

20. Shqyrtimi i raportit vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017 diskutuan deputetët: Shqipe Pantina, në emër të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe në emër të GP të PSD-së; Imet Rrahmani, në emër të GP të LDK-së; Xhevahire Izmak, në emër të GP të PDK-së; Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së dhe Milaim Zeka, në emër të GP të NISMA-s, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 55,
Kundër----- 2,
Abstenime-----10.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i statistikave zyrtare për vitin 2017.

21. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017 diskutuan deputetët: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Ali Lajçi, në emër të GP të LVV-së; Frashër Krasniqi, në emër të GP të PSD-së; dhe Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 48,
Kundër----- 3,
Abstenime-----19.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017.

22. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017 diskutuan deputetët: Blerim Kuçi, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të GP të AAK-së, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017 është bërë më 14 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 44,
Kundër----- 18,
Abstenime----- 5.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017.

23. Shqyrtimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017 diskutuan deputetët: Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Shkumbin Demaliaj në emër të GP të AAK-së; Drita Millaku dhe Milaim Zeka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017 është bërë më 14 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 60,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017.

25. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

26. Emërimi i një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi i ka rekomanduar Kuvendit zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, prej dy kandidatëve të propozuar.

Gjithashtu, Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka rekomanduar Kuvendit emërimin e një (1) anëtari nga kandidatët e propozuar.

Kryetari propozoi që votimi i fshehtë të bëhet përnjëherë me kandidatët për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovë dhe për emërimin e një (1) anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit.

Pastaj, kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Fidan Rekaliu, GP LDK,
Evgjeni Thaçi, GP PDK,
Valon Ramadani, GP LVV,
Salih Salihu, GP PSD,
Rasim Selmanaj, GP AAK,
Jelena Bontiq, GP Lista serbe,
Enver Hoti, GP Nisma dhe
Danush Ademi, GP “6+”.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë procedurat e votimit të fshehtë për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovë dhe për emërimin e një (1) anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovë e paraqiti deputetja Evgjeni Thaçi- Dragusha.

Rezultati i votimit ishte:

Në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë:

- Të pavlefshme ishin 4 fletëvotime.
- Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin si në vijim:

1. Bislim Zogaj i ka fituar 45 vota,
2. Besim Mulaj i ka fituar 36 vota.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Z. Bislim Zogaj zgjidhet drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

2. Mandati i drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës është pesë (5) vjeçar.

Në vazhdim, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për emërimin e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës e paraqiti deputetja Evgjëni Thaçi- Dragusha.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë:

- Të pavlefshme ishin 4 fletëvotime.
- Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin:

1. Arian Krasniqi i ka fituar 39 vota dhe
2. Labeat Abdullahu i ka fituar 42 vota.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Kandidatët e propozuar: Arian Krasniqi dhe Labeat Abdullahu, për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shqiptar, nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i këtij Bordi.

2. Përsëritet konkursi për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar.

27. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve joshumicë

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018 ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Më pas, kryetari e hodhi në votim formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----71,
Kundër-----1,
Abstenime-----0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve joshumicë në këtë përbërje:

1. Imet Rrahmani,nga GP i LDK-së, kryetar,
2. Rasim Selmanaj,nga GP i AAK-së, zv.kryetar i parë,
3. Albert Kinolli,nga GP "6+", zv.kryetar i dytë,
4. Arban Abrashi,nga GP i LDK-së, anëtar,
5. Mexhide Mjaku-Topalli,nga GP i PDK-së, anëtare,
6. Nait Hasani,nga GP i PDK-së, anëtar,
7. Valon Ramadani,nga GP i LVV-së, anëtar,
8. Adem Mikullovc,nga GP i LVV-së, anëtar,
9. Frashër Krasniqi,nga GP i PSD-së, anëtar,
10. Jelena Bontiq,nga GP i Listës serbe, anëtare dhe
11. Milaim Zeka,nga GP i Nisma-s, anëtar

II. Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve joshumicë duhet të veprojë në përputhje me nenin 11 paragrafi 2.2 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 18:35.

* * *

E premte, më 8 qershor 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Kujtim Shala dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditë si në vijim:

4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP LVV dhe të GP LDK në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se GP i Lëvizjes Vetëvendosje dhe GP i Lidhjes Demokratike të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës.

Gjithashtu ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës. Diskutimi i plotë i deputetit Albin Kurti është dhënë në transkript.

Gjithashtu edhe deputeti Lumir Abdixhiku, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e paraqiti dhe arsyetoi kërkesën për këtë interpelancë. Diskutimi i plotë i deputetit Lumir Abdixhiku është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e paraqiti dhe e arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. Diskutimi i plotë i kryeministrit Ramush Haradinaj është dhënë në transkript.

Lidhur me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës diskutuan deputetët: Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Xhevahire Izmaqi, në emër të GP të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zaka, në emër të GP të NISMA-s, Arbërije Nagavci, Visar Ymeri, Rasim Selmanaj, Armend Zemaj, Bekim Haxhiu, Sami Kurteshi, Blerim Kuçi, Driton Selmanaj, Memli Krasniqi, Naser Rugova, Muharrem Nitaj, Milaim Zeka, Korab Sejdiu, Glauk Konjufca, Ahmet Isufi, Lumir Abdixhiku dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve, deputeti Albin Kurti në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, e paraqiti tekstin e Propozim-rezolutës lidhur me interpelancën e kryeministrit.

Deputeti Lumir Abdixhiku, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkoi që të harmonizohen qëndrimet lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë.

Votimi i rezolutës nga interpelanca e kryeministrit në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës është bërë më 12 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----40,
Kundër-----29,
Abstenime-----4.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Qeveria menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute të fillojë nga zbatimi i të gjitha detyrimeve nga Ligji për ndërmarrjet publike duke anuluar çdo vendim tjetër që bie ndesh me këtë ligj.
2. Qeveria 15 ditë nga miratimi i kësaj rezolute të ngrejë shtabin e menaxhimit të krizës në këto dy ndërmarrje me qëllimin ristrukturimin e thellë të veprimtarisë biznesore, të burimeve njerëzore dhe të planit të investimeve. Ristrukturimi i Telekomit të Kosovës të përfshijë ngrirjen e të gjitha pozitave udhëheqëse në Telekom, dhe angazhimit të një institucioni kompetent për menaxhimin emergjent të kësaj ndërmarrjeje deri në rikonsolidimin e plotë të saj.
3. Përbërja e shtabit të krizës, termat e referencës dhe profili i anëtarëve të përcaktohet në bashkëpunim me Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe Qeverisë së Kosovës.
4. Të tërheqë anëtarët aktualë të Bordit të emëruar pa bazë profesionale dhe të propozojë anëtarë me integritet të lartë dhe profesionistë me përvojë të gjatë në fushën e telekomunikacionit, financave dhe administrimin të ndërmarrjeve.
5. Auditori i përgjithshëm menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute të fillojë auditimin e performancës dhe auditimin e financave të Telekomit dhe Postës së Kosovës.
6. Qeveria në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës të shqyrtojë pas ristrukturimit të thellë të strukturës organizative të Telekomit, moratoriumin për pagesën e dividendës nga Telekomit i Kosovës për një periudhë dyvjeçare dhe monitorimin në punësim në Telekomin e Kosovës.
7. Qeveria e Kosovës, si aksionari kryesor, duhet të tërhiqet nga marrëveshja abuzive e ish-drejtorit të Telekomit me kompaninë Z-Mobile.
8. Kryeministri t'i raportojë Kuvendit jo më larg se 30 ditë nga miratimi i kësaj rezolute për masat e marra në Telekomin dhe në Postën e Kosovës.
9. Në afat prej një muaji pas dorëzimit të raportit sipas pikës 8, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të ndërmarrë një shqyrtim gjithëpërfshirës për të analizuar të gjeturat e raportit të Qeverisë, përfshirë këtu ftesën për raportim në komision të zyrtarëve që komisioni e sheh të arsyeshme, dhe të njoftojë Kryesinë e Kuvendit.
10. ARKEP të zbatojë ligjin, duke njoftuar sa më parë lidhur me tarifat e reja të licencimit të Telekomit të Kosovës.
11. Qeveria të bëjë publike të gjitha dokumentet lidhur me titullin e pronësisë së Kodit telefonik +383 dhe ARKEP të marrë masa për pezullimin e përdorimit të kodit të Serbisë +381.
12. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton Prokurorinë e Kosovës që të vendosë në prioritet hetimin e kontratës me Dardafon (më tej Z-Mobile).

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 19:15.

E enjte, më 14 qershor 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Në fillim të vazhimit të kësaj seance u miratuan raportet vjetore të agjencive të pavarura, rezultatet e këtyre votimeve janë pasqyruar së bashku me shqyrtimet e pikave përkatëse.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

28. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se grupet parlamentare të LVV-së, PSD-së dhe Listës serbe kanë propozuar zëvendësimet dhe emërimet e reja të deputetëve në komisionet parlamentare.

Pastaj, deputetja Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së dhe Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së, dhanë sqarimet për ndryshimet e propozuara në komisionet parlamentare. Diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Në vazhdim kryetari i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare të LVV-së, PSD-së dhe Listës serbe për zëvendësimet dhe emërimet e reja të deputetëve në komisionet parlamentare.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 06-V-006

I. Vendimi nr. 06-V-006, datë 3 tetor 2017, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, në komisionet parlamentare përfaqësohen si në vijim:

1.1. Komisioni për Buxhet dhe Financa: Arbërie Nagavci, anëtare (GP LVV), Ali Lajçi, anëtar (GP LVV) dhe Dardan Molliqaj, anëtar (GP PSD).

1.2. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit: Albulena Haxhiu, kryetare, (GP LVV), Sami Kurteshi, anëtar (GP LVV) dhe Frashër Krasniqi, anëtar (GP PSD).

1.3. Komisioni për Integritet Evropian: Ismajl Kurteshi, anëtar (GP LVV), Fatmire Kollçaku, anëtare (GP LVV) dhe Visar Ymeri, anëtar (GP PSD).

1.4. Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike: Glauk Konjufca, anëtar (GP LVV), Fitore Pacolli, anëtare (GP LVV) dhe Dukagjin Gorani, anëtar (GP PSD).

1.5. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi: Ismajl Kurteshi, kryetar (GP LVV), Arbërie Nagavci, anëtare (GP LVV) dhe Driton Çausi, anëtar (GP PSD).

1.6. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal: Liburn Aliu, anëtar (GP LVV), Glauk Konjufca, anëtar (GP LVV) dhe Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë (GP PSD).

1.7. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor: Liburn Aliu, anëtar (GP LVV), Sali Zyba, anëtar (GP LVV) dhe Salih Salihu, anëtar (GP PSD).

1.8. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale: Besa Baftiu, kryetare (GP PSD), Fatmire Kollçaku, anëtare (GP LVV) dhe Drita Millaku, anëtare (GP LVV).

1.9. Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media: Valon Ramadani, anëtar (GP LVV), Adem Mikullovc, anëtar (GP LVV) dhe Shqipe Pantina, zëvendëskryetare e parë (GP PSD).

1.10. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës: Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë (GP LVV), Xhelal Sveçla, anëtar (GP LVV) dhe Aida Dërguti, anëtare (GP PSD).

1.11. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione: Saranda Bogujevci, anëtare (GP LVV), Shemsi Syla, anëtar (GP LVV) dhe Fisnik Ismaili, anëtar (GP PSD).

1.12. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike: Ali Lajçi, anëtar (GP LVV), Valon Ramadani, anëtar (GP LVV) dhe Faton Topalli, anëtar (GP PSD).

1.13. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë: Shemsi Syla anëtar (GP LVV) dhe Arbër Rexhaj, anëtar (GP LVV).

2. Deputeti Sasha Milosavljeviq, nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, emërohet zëvendëskryetar i dytë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetes Miljana Nikoliq.

5. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të LDK-së, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikallo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikallo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione.

Gjithashtu, ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikallo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione. Diskutimi i plotë i deputetit Lutfi Zharku është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e paraqiti dhe e arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. Diskutimi i plotë i kryeministrit Ramush Haradinaj është dhënë në transkript.

Lidhur me vendimet e Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikallo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione, diskutuan deputetët: Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të PSD-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s, Adem Mikullovc, Enver Hoti, Naser Rugova, Sami Kurteshi, Muharrem Nitaj, Milaim Zeka, Korab Sejdiu, Glauk Konjufca, Ahmet Isufi dhe Lumir Abdixhiku, si dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve deputetja Mimoza Kusari-Lila, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i lexoi rekomandimet lidhur me interpelancën e kryeministrit.

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, nuk u procedua me votimin e rekomandimeve.

Në seancën plenare të mbajtur më 23 korrik 2018 është hedhur në votim propozim-rezoluta, e cila u është shpërndarë deputetëve më 18 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 38
Kundër -----52
Abstenime ----- 4

Kuvendi nuk e miratoi Propozim-rezolutën e propozuar nga GP i LDK-së në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikallo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës më 14 qershor 2018, në orën 14:30.

Kryetari i Kuvendit:
KADRI VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*